

Termtat e Referencës

Kërkesë për ofertë – Ekspert/e apo kompani

Për

Zhvillimi i Kurrikulës - Plan Programit për Udhërrëfyes Turistik për Nivelin e V_të të KKK_së

Numër reference: 106/SiV/2022

Syri i Vizionit (SiV) është regjistruar zyrtarisht si organizatë joqeveritare lokale në shtator të vitit 2001, por ka filluar të funksionojë edhe më herët, që nga viti 1999, si Organizatë e Bazuar në Komunitet (CBO) në komunën e Pejës. Që nga fillimi, motoja e organizatës ka qenë “Mendo globalisht, vepro lokalisht”, të cilës organizata i ka qëndruar besnike. Misioni i organizatës është “Zhvillimi i komunitetit të njerëzve, grupeve joformale, organizatave, rrjeteve, institucioneve dhe donatorëve përmes avokimit, shkëmbimit të informacionit dhe ndërgjegjësimit” dhe SiV përmes veprimit të saj dëshmon se është një organizatë që kryen veprime lokale bazuar në praktikatat më të mira.

Informata të përgjithshme

Programi SEED faza e tretë mbështetet nga ADA dhe realizohet në dy shtete: në Kosovë dhe Serbi dhe ka për qëllim që të kontribuojë në zhvillimin strategjik të tregut të punës, një kontribut për uljen e varfërisë dhe barazinë gjinore në këto shtete. Programi tre vjeçar në Kosovë realizohet nga organizata “Syri i Vizionit” dhe fokusohet në nxitjen e partneritetit të qëndrueshëm që shtyn në krijimin e një kornize aktive të tregut të punës në nivel lokal dhe në qasjen në punësim formal. Një vëmendje e veçantë u është dhënë të rinjve dhe grave përmes: mbështetjes në punësim, lehtësimit në mes sektorit publik dhe privat, forcimit të organizatave partnere, ekspertizës dhe transferimit të njohurive, promovimin e punësimit ose vetëpunësimit në kushte të drejta pune dhe rritjes së ndërgjegjësimit për barazi gjinore.

Në të tri komunat Pejë, Gjakovë dhe Prizren, ku është paraparë realizimi i projektit, Syri i Vizionit do të punojë ngushtë me Komunitat e Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Kulturës, Rinisë edhe Sportit, Zyrrat rajonale të punësimit, Zyrrat për barazi gjinore në komuna, hotelet dhe restorantet, operatorët turistik, autoritete lokale të arsimit, Inspektoratet e Edukimit, Drejtoritë e zhvillimit ekonomik, Agjencitë e Zhvillimit Rural, institucionet e larta të arsimit dhe institucionet e arsimit dhe aftësisimit profesional.

Në nivel lokal në komunat e lartcekura këta akterë do të njihen si grupi lokal për punësim. Këta akterë do të jenë të përfshirë drejtpërdrejt në aktivitetet e projektit, duke marrë pjesë në dialog dhe punëtori që do organizohen në kudër të projektit, duke kontribuar dhe zhvilluar strategji lokale për punësimin e të rinjve dhe grave. Ndërsa, në nivel kombëtar Syri i Vizionit do të

organizojë takime dhe konferenca për të koordinuar dhe adresuar punët në mes të palëve të interesuara nga niveli lokal në atë qendror.

Objektivat kryesore:

Syri i Vizionit në kuadër të projektit SEED faza III, kërkon të angazhoj ekspert/e apo kompani për zhvillimin e plan programit – kurrikulës për udhërrëfyes turistik, i cili do të bazohet në standardin e profesionit te nivelit 5 në Estoni për udhërrëfyes turistik (për të cilën kemi marr aprovim me shkrim se mund të përdoret, dhe të zhvillohet plan program për Kosovë) dhe do ofrohet nga universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë, ku do shfrytëzohet resurset humane, teknologjike dhe logjistike të universitetit për ta ofruar këtë program. Trajnimi dhe certifikimi i udhërrëfyesve turistik do ofrohet për herë të parë në Kosovë dhe do ofrohet nga një institucion i arsimit e lartë, universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë, i cili do kontribuoj në zhvillimin e kuadrove profesional të cilët kërkohen në tregun e punës.

Objektivi specifik:

Hartimi i kurrikules (plan programit) për udhërrëfyes turistik (Guida Turistike) në Institucionet e Arsimit të lartë në profilin e hotelerisë dhe turizmit me titull “Udhërrëfyes Turistik” në koordinim me universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, dhe të bazuar në standardin e profesionit për Guide Turistike të nivelit 5 të Kornizës Kombëtare për Kualifikime (KKK), sipas standardit të kualifikimeve kombëtare, ky trajnim mund të zgjasin deri dymbëdhjetë (12) muaj, dhe do ofrohen si mundësi shtesë për të rinjtë e të rejtat nga vendi dhe rajoni që të certifikohen për udhërrëfyes turistik si dhe të arkëtojnë ECTS të cilët mund t'i shërbejnë për studime të mëtejshme .

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Shqyrtimi dhe analizimi i akteve ligjore dhe nënligjore për kualifikime, të cilat rregullojnë çështjet e zhvillimit të kurrikulave të reja sipas nivelit të 5 të kualifikimeve që mund të ofrohen edhe arsimin e lartë në Kosovë.
- Analizimi i standardit të profesionit niveli 5, për udhërrëfyes turistik (Guide Turistike) i aprovuar nga autoriteti Estonez i kualifikimeve, në bazë të secilit do të zhvillohet edhe kurrikula për udhërrëfyes turistik për nevojat e vendit, dhe i cili do të ofrohet nga universiteti “Haxhi Zeka” Pejë <https://www.kutseregister.ee/ctrl/en/KAO/vaata/10086638>
- Analizimi i kurrikulës bërthamë në drejtimin e hotelerisë dhe turizmit në universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, me fokus në modulet që ndërlidhën më përmbajtjet për udhërrëfyes turistik
- Zhvillimi i analizave për strukturën, kohëzgjatjen dhe metodat e zhvillimit te kurrikules (modulare), metodat e trajnimit, duke përfshi të gjitha palët e interesit (shkollat, bizneset, institucionet lokale dhe nacionale si dhe individ më asociime profesionale të nevojshme për zhvillimin e analizës)
- Ne bashkëpunim me SIV themelon grupit me profesionist të turizmit të cilët do të kontribuojnë në përcaktimin e përmbajtjeve të kurrikulës (modulet)

- Organizimi dhe fasilitimi i takimeve të grupit punues për zhvillim të kurrikulës (përfshirë elementet përbërëse të pakos mësimore) për guida turistike në Kosovë
- Organizimi i punëtorive me grupin punës (përfshi stafin e drejtimit hoteleri dhe turizëm, dhe gjithë palët tjera të cilët mund të japin kontribut) për hartimin e kurrikulës për udhërrëfyes turistik;
- Organizimi i takimeve me palët e interesit për diskutim të draftit të kurrikulës së propozuar, mbledhja dhe përpunimi i informatave kthyesë dhe inkorporimi i tyre.
- Zhvillimi i metodave dhe procedurave të vlerësimit dhe certifikimit të kandidateve
- Organizimi i takimeve me palët e interesit dhe mbledhja e informatave për zhvillimin e trajnimit për guida turistike në Kosovë.
- .
- Finalizimi i kurrikulës dhe përbajtjeve mësimore (lista e materialeve dhe përmbajtjeve të nevojshme)
- Asistimi i stafit të universitetit “Haxhi Zeka” në përgaditjen e të gjithë dokumentacionit për akreditimi të plan programit “Udhërrëfyes Turistik” në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) në Kosovë

Pagesa:

SiV do të paguajë ekspertin/ën apo kompaninë me vlerën e dakorduar, nga e cila do të zbriten dhe paguhen tatimet në të ardhura dhe kontributet pensionale, në bazë të Ligjit të Kosovës.

Eksperti/ja apo kompania pritet të dorëzojë të gjitha rezultatet brenda afatit kohor të dakorduar, në mënyrë që të pranojë pagesën e plotë, apo të ndarë në rata, varësisht nga punët e kryera dhe sipas marrëveshjes.

SiV do ta bëjë pagesën përmes transferit bankar në llogarinë bankare të ekspertit/es apo kompanisë. Tarifa e ofruar do të përfshijë të gjitha shpenzimet e nevojshme të udhëtimit dhe të komunikimit.

Aplikimi:

Kandidatët e interesuar ftohen që të aplikojnë duke i dërguar dokumentet e mëposhtme:

- Kopjen e Diplomës Universitare në fushë relevante (ndonjë Certifikatë e Licencimit nga institucione relevante apo dokument/plan program të hartuar me parë konsiderohet përparësi);
- Përshkrimin e metodologjisë së punës, duke përfshirë planifikimin dhe analizimit e procesit dhe situatës për zhvillim të kurrikules të nivelit 5 të KKK-se në Kosovë, mbajtjes së punëtorive dhe hartimin e plan programit etj.
- Një plan tentativë të punës;
- Një letër motivuese ku përfshihet përvoja, gatishmëria dhe aftësitë profesionale në zhvillimin e hartimin e plan programeve trajnuese (bashkëngjit ndonjë kopje);
- Curriculum Vitae (CV) në gjuhën shqipe ose angleze;

- Propozimin financiar*

Oferta financiare duhet të jetë e detajuar për secilën detyrë që do të realizohet, duke përfshirë: planin tentativë të punëtorive, takimet me palët e interesit, dhe hartimin e plan programit – kurrikulës për udhërrëfyes turistik

Aplikacionet duhet të dorëzohen në gjuhën lokale, në formë elektronike në e-mail adresën: info@syriivizionit.org ose dukagjin.nishiqi@syriivizionit.org me subjektin: Aplikacioni për Hartimin e plan programit për udhërrëfyes turistik, apo edhe përmes postës në adresën e organizatës: OJQ “Syri i Vizionit”, Rr. Isa Demaj, nr. 14, 30000 Pejë, Kosovë.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 24 qershor 2022, ora 16:00.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!